

Partia "PARTIA BALLI KOMBETAR"

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

**Mbi perdorimin e fondeve te perfituara per fushaten
zgjedhore te 8 Majit 2011 "Per zgjedhjet vendore ne
Republiken e Shqiperise"**

**EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR
Nikolla GECO**

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR: NIKOLLA GECO
Shërbime auditimi
Shërbime Kontabiliteti
e-mail: nikogeco@yahoo.com

Adresa Profesionale
Rr. Durrësit, p.85, sh.6, ap.47
TIRANE

RAPORT I AUDITORIT TE PAVARUR

DREJTUAR :

1. KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE :
Adresa ; Pallati Kongreseve

TIRANE

Te nderuar zoterinj !

Duke ju falenderuar per besimin qe na dhate duke na ngarkuar te kryejme kontrollin ligjor mbi perdorimin e fondeve te perfituara gjate fushates zgjedhore te Partise "Partia Balli Kombetar" per periudhen deri ne 8 Maj 2011. Me ane te ketij relacioni kemi nderin te paraqesim raportin tone "Mbi Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara per Fushaten Zgjedhore te 8 Majit "Per zgjedhjet vendore ne Republiken e Shqiperise"

Kontrolli eshte kryer mbi bazen e testimit te dokumentacionit te perdorur dhe te gjetur ne zyrtar e subjektit zgjedhor per transakcionet ekonomiko-financiare te kryera gjate fushates zgjedhore dhe qe gjejne pasqyrim ne shumate e paraqitura ne llogarite financiare (Bilanc dhe anekset e tij).

Per permbushjen e misionit tim, kam vleresuar metodat dhe parimet e perdorura per mbajtjen e kontabilitetit si edhe te paraqitjes se deklarimeve financiare.

Pergatitja e ketyre pasqyrave financiare eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit zgjedhor. Pergjegjesia jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Ne besojme se auditimi i kryer jep nje baze te arsyeshme per opinionin.

"PARTIA BALLI KOMBETAR" RAPORTI DHE PASQYRAT FINANCIARE



Niko Geco

1. PASQYRAT FINANCIARE

Kontrolli I bilancit financiar ne pergjithesi ne:

- ☞ Njohjen e Subjektit zgjedhor, (Dokumentat ligjore, dhe ekonomike. Aktivitetit te zgjerimi I tij ne rrethe te tjera)
- ☞ Rakordimin me te dhenat e kontabilitetit.
- ☞ Reflektimin ne menyre besnike te gjendjes financiare te subjektit deri ne daten 8 Maj 2011.
- ☞ Paraqitjen ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- ☞ Marrjen parasysht te ngjarjeve me rëndesi te vecante qe kane ndodhur pas dates 8 Maj 2011.

1.1 Baza Ligjore

Per kontrollin e te dhenave financiare u bazuam ne dispozitat ne fuqi,

- Ligji nr.10019 date 29/12/2008 "Kodi zgjedhor I Republikes se Shqiperise"
- Ligji nr.10091 dt. 05/03/2009 "Per Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilitet te Miratuar"
- Ligjit nr. 9228 date 29/04/2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne baze dhe per zbatimin e tyre.
- Udhezimi I KQZ Nr.8 date 25.03.2009, Per miratimin e kriterëve dhe procedurat per perzgjedhjen dhe emerimin e eksperteve kontabel te licensuar per auditimin e fondeve te përfuturës dhe te shpenzuara nga subjektet zgjedhore per fushqten zgjedhore".

Situata financiare e paraqitur nga subjekti ne Pasqyrat Financiare mendoj se rakordon me te dhenat e kontabilitetit dhe paraqet ne menyre besnike gjendjen e subjektit deri ne daten 8 Maj 2011.

Nikollos



1.2 Statusi I shoqerise

"Partia e Ballit Kombetar" eshte krijuar mbi bazen e ligjit nr. 8560 dt.17/02/2000 "Per Partite Politike" rregjistruar si person juridik ne baze te Urdherin Nr.39/1 date 04.10.1991 te Ministrise se Drejtesise dhe me vendimin Nr.2 dt.03.04.1993 te Gjykates se Kasacionit me emertimin Partia e Ballit Kombetar me Kryetar Z.Adriatik Alimadhi . Kjo parti nuk eshte e rregjistruar ne organet tatimore.

Drejtimi i Partise behet nga Kryesia e Partise.

Administrimi I saj behet nga Kryetari I parties.

1.3 Auditimi I Deklarateve financiare te parashikuara nga ligji.

- Auditimin me sinqeritet te informacioneve te tipit kontabel qe figurojne ne raportin e drejtimet e kemi kryer ne zbatim te ligjit nr.10019 date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor I Republikes se Shqiperise" me konkretisht ne keto drejtime:

1. Zbatimi I nenit 87 te ligjit nr. 10019 date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor I Republikes se Shqiperise",

Nga Auditimi qe ju krye zbatimit te nenit 87 rezultoi se per periudhen e kontrolluar subjekti zgjedhor nuk kishte perfituar fonde publike dhe per rrjedhoje nuk i nenshtrohet detyrimit per kthimin e fondeve ne zbatim te pikes 3 te nenit 87. (deklarata e subjektit). Gjithashtu nga ana jone u verifikuan te keto te dhena edhe ne celjet e fondeve te kryera nga MInistria e Financave per llogari te subjektit zgjedhor.

2. Zbatimi I nenit 88 te ligjit nr. 10019 date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor I Republikes se Shqiperise",

Nikollos



Nga te dhenat qe na u vune ne dispozicion te auditimit rezultoi se per periudhen e kontrolluar nuk rezultuan fonde publike ne nivel qendror ose vendor, apo cdo lloj enti tjeter ku shteti zoteron kapitale qe te mund te perdoreshin ose te viheshin ne mbeshtetje te kandidatit, te subjektit zgjedhor.

3. Zbatimi i nenit 89 te ligjit nr. 10019 date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor I Republikes se Shqiperise",

Nga auditimi qe ju krye formes dhe permbajtjes se informacioneve specifike rezultoi, se per fushaten zgjedhore subjekti nuk kishte perfituar fonde jo publike nga persona fizike ose juridike vendas, qe te kene kaluar kufirin 100.000 leke, duke respektuar ne kete menyre piken 2 te nenit 89. Gjithashtu ne verifikim nuk rezultoi qe te subjekti te kete perfituar fonde nga persona juridik apo cdo aksionar i tij, sipas kufizimeve te percaktuara ne piken 3 germa (a,b,c,ç) te nenit 89 te ligjit.

4. Nga auditimi qe ju krye formes dhe permbajtjes se informacioneve specifike rezultoi: ne gjendjen financiare dhe llogarite e subjektit zgjedhor ka sinqeritet dhe paraqitje korrekte te tyre. Nuk kemi ndonje parregullsi, pasaktesi dhe shkelje te konstatuara ne zbatimin e parimeve e normave kontabel, dispozitat e statuteve, te subjektit, vendimet e drejtimit. Nuk kemi ndonje ngjarje ose informacion te rastit qe te kete ndikim ne deklarimet financiare te subjektit zgjedhor.

5. Auditimi I fondeve te perfituara nga kuotat e anetaresise

Ne zbatim te ligjit nr. 8560 dt. 17.02.2000 "Per Partite Politike", anetaret e partise derdhin kuota anetaresie ne perputhje, te cilat perdoren per shpenzimet e subjektit zgjedhor. Nga auditimi qe ju krye zbatimit te ligjit dhe statutit te partise mbi bazen e dokumentave

Nikol Geco



EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR: NIKOLLA GECO
Shërbime auditimi
Shërbime Kontabiliteti
e-mail:nikogeco@yahoo.com

Adresa Profesionale
Rr. Durrësit,p.85,sh.6,ap.47
TIRANE

qe na afruan dhe investigimeve me te anetaret, nuk rezultoi qe ndonje anetar te kete derdhur kuota apo te jete perdorur ne favor te subjektit zgjedhor.

➤ OPINIONI

Ne perfundim te verifikimeve dhe kontroleve, jam ne gjendje te vertetoj se deklaratat e informacionet financiare qe ianeksohen ketij raporti jane te sinqerta dhe te rregullta dhe japin nje pamje besnike te situates financiare dhe gjendjes pasurore te Subjektit zgjedhor me date 8 Maj 2011

Tirane, me 11.01.2012

AUDITUESI

Nikolla GECO



"PARTIA BALLI KOMBETAR" RAPORTI DHE PASQYRAT FINANCIARE

KLIENTI : PARTIA BALLI KOMBETAR

Plani punes se auditimit te fondit te fushates zgjedhore 2011 te Partise Partia Balli Kombetar

Nr	Peshkrimi i punes	Oret e punes
1	Pune per gatitore per misionin 1.1 Njohja me ftesen e KQZ per aplikimin ne tender, Verifikimi papajtueshmerive ligjore, per gatitja e dokumentacionit dhe kthimi i pergjigjes per fazen e pare te aplikimit. 1.2 Pergatitja e dokumentave shtese per fazen e dyte 1.3 Lidhja e kontrates me KQZ-ne 1.4 Hartimi i planit te punes	4 2 2 2
2	Njohja me legjislacionin per financimin e Partive dhe te fushates zgjedhore.	1
3	Kontakte me stafin drejtues dhe administrues te Partise Partia Balli Kombetar per prezatimin e misionit te auditimit te fondeve te fushates.	2
4	Nohja e pergjithshme e dokumentave dhe evidences kontabile per pasqyrimin e ardhurave dhe shpenzimeve te fushates zgjedhore 2011	2
5	Verifikimi i fondit te perfituar sipas burimit per fushaten zgjedhore 5.1 Nga buxheti i shtetit; 5.2 Nga fondet e veta te Partise Partia Ballit Kombetar ; 5.3 Nga sponsorizimet ne llogari bankare ; 5.4 Nga sponsorizimet CASH nepermjet arkes; 5.5 Sponsorizime me materiale publicitare.	1 1 1 1 1
6	Verifikimi i shpenzimeve te fushates sipas destinacionit te kryer per: 6.1 Marje salla me qera; 6.2 Reklama televizive; 6.3 Reklama ne radio; 6.4 Shpenzime telefonike; 6.5 Shpenzime per postera, fletevolante, fletepalosje; 6.6 Shpenzime kancelarie; 6.7 Shpenzime per karburant; 6.8 Pagesa e firmave konsulente; 6.9 Shpenzime per pagat dhe sigurimet shoqerore e shendet.	2 2 1 2 2 2 2 1 2
7	Kontakte dhe verifikime te vecanta sipas nevojës qe do te paraqitet	1
8	Sistemimi i materialeve te kontrolluara, verifikime te ceshtjeve te nevojeshme dhe per gatitja per raportit	2
9	Hartimi i raportit te auditimit sipas SNA -se 800	6
10	Dorezimi i raportit ne KQZ.	2
	Total i kohes se punes se Parashikuar	47

EKR. Nikolla Geco